



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Adresa Rr. Zija Shemsiu pn, 60000 Gjilan, Republika e Kosovës
www. uni-gjilan.net

Rektori: Prof. Dr. Bajram Kosumi

Vendim.nr. 01/526 / 05/03/2021

Në bazë të nenit 48, pika 1.3 të Statutit të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, Senati i Universitetit, në mbledhjen e vet të mbajtur më 04.03.2021, mori:

VENDIM

Dr.sc. Arbona Xhemajli, zgjedhet në thirrjen akademike **Profesor Asistent** për lëndë nga fusha e pedagogjisë në Fakultetin e edukimit në Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjilan.

Zgjedhja është bërë në pajtim me kushtet e parapara në nenin 153 dhe 157 të Statutit të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan dhe Rregulloren për procedurat për zgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ.

E përmendura është e obliguar që t'u përmbahet dispozitave të Statuti të Universitetit.

Emërimi zgjatë 4/katër/vite.

Të përmendurës i takon paga në pajtim me Rregulloren për të ardhurat personale.

Kontrata e punës do të lidhet në pajtim me dispozitat pozitive.

Arsyetim

Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan ka shpallur konkurs për zgjedhjen/rizgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndë nga fusha e pedagogjisë në Fakultetin e edukimit në Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjilan.

Komisioni recensues dhe Komisioni i studimeve i ka propozuar Senatit të Universitetit që Dr. Sc. Arbona Xhemajli, i plotëson kushtet për t'u zgjedh në thirrjen akademike Profesor Asistent për lëndët e sipërpërmendura.

Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, duke i marrë për bazë vlerësimin e Komisionit Recensues dhe propozimin e Komisionit të Studimeve, vendosi që Dr.sc. Arbona Xhemajli, të zgjedhet në thirrjen akademike Profesor Asistent.

Në bazë të kësaj që u tha më sipër u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit në web faqe, Komisionit për Ankesa dhe Parashtresa të Senatit të Universitetit.

Prof. Dr. Bajram Kosumi, rektor
Kryesues i Senatit

Vendimi t'i dërgohet:

1. Të përmendurit
2. Zyrës së personelit
3. Arkivit të Universitetit
4. Zyrës së financave

